



**Përmbledhje e Aktivitetit të Misionit të RSH-së
në Këshillin e Sigurimit
(Java 3)**

17 - 21 janar 2022

17 janar 2022

Sudani - ICC: Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Karim Khan, informoi Këshillin lidhur me përpjekjet e zyrës së tij për të zbatuar 4 mandatet që GJPN ka lëshuar për 4 individë nga Sudani.

Në fjalën e tij, Ambasadori Hoxha shprehu mbështetjen e Shqipërisë ndaj ICC/Prokurorit Khan duke theksuar rëndësinë që ka dhënia e drejtësisë për krimet e kryera kundër njerëzimit përfshirë krimet ndaj grave dhe fëmijëve. Ai theksoi se Shqipëria shpreh shqetësim për situatën e paqëndrueshme të sigurisë në Sudan dhe për sulmet e vazhdueshme ndaj civilëve, shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve ushtarake sudaneze. Shqipëria u bën thirrje autoriteteve ushtarake, shërbimeve të sigurisë, grupeve të armatosur që të ndalin sa më parë sulmet ndaj protestuesve civilë, dhunën seksuale, shkeljet e të drejtave të njeriut që janë intensifikuar që prej marrjes së pushtetit nga forcat ushtarake më 25 tetor 2021.

Takimi konfirmoi edhe një herë qëndrimet e ndryshme në Këshill, ku nga njëra anë Shqipëria, SHBA, M.B, Francë, Norvegji, Gana, Gaboni, Meksika dhe nga ana tjetër, Rusia dhe Kina, kanë për çështjen e hetimit të krimeve të kryera në Darfur, Sudan. Bie në sy kundërshtimi i hapur i Ruisë dhe kritika ndaj ICC dhe Zyrës së Prokurorit, qëndrim që Rusia e ka shprehur edhe gjatë raportimit të Khan për situatën e Libisë në 2021.

Pas përfundimit të takimit Shqipëria, Meksika, M.B, Franca, Brazili, Norvegjia, Irlanda, Gana dhe Gaboni dolën me një deklaratë të përbashkët publike që u lexua nga Meksika në rolin e koordinatorit ndërmjet Këshillit të Sigurimit dhe ICC.

Shënim: Shqipëria shfytëzoi këtë takim ashtu si edhe cdo rast tjetër në Këshill për të theksuar qartë e me forcë qëndrimin tonë për moslejimin e pandëshkueshmërisë, dhënien e drejtësisë për

dhunën në konflikte, duke pasur gjithnjë parasysh edhe në kontekstin e rajonit tone dhe asaj që ka ndodhur në Kosovë.

Qipro (UNFICYP): KS zhvilloi një takim konsultimesh mbi Qipron. Në qëndrimet në KS, edhe pse pati nuanca, nuk u vunë re ndryshime të mëdha e të tilla që mund të vënë në diskutim miratimin e rezolutës për ripërtëritjen e mandatit 6-mujor të UNFICYP. P3 ishte më e kufizuar në terminologji, duke përdorur vetëm termin i Dërguari i OKB-së cka lë hapësirë negocimi mbi emërtimin e saktë, modalitetin e emërimit dhe mandatin e tij. Ndërkohë P2 (Rusia dhe Kina) përdorën termin i Dërguari Special, i cili duhet të jetë i mandatuar nga KS. Ky variant nuk pranohet nga pala turko-qipriote.

ZvPërfaqësuesja e Përhershme Dautllari theksoi mbështetjen për një zgjidhje politike, paqësore dhe realiste brenda kuadrit të OKB-së, për krijimin e një Mekanizmi për Kontakt të Drejtpërdrejtë ushtarak mes dy palëve. Gjithashtu, ajo përshëndeti miratimin e Planit të Veprimit mbi përfshirjen e grave në procesin e dialogut dhe negociatave. Pas takimit presidenca norvegjeze prezantoi publikisht elementët e një deklaratë e cila u dakordësua paraprakisht në KS.

Negociatat mes palëve janë ndërprerë që në vitin 2017. Meqë turko-qipriotët kërkojnë fillimin e një procesi krejt të ri negociatash, SRSG do të synojë gjetjen e një zgjidhje të ndërmjetme, që mund t'i afrojë të dyja palët. Ranë në sy qëndrimet e ashpra të Kinës dhe Indisë kundër Turqisë, cka lidhet me problematika të tjera në aspektin dypalësh.

Shënim: Rezoluta për rinovimin 6 mujor të mandatit të misionit është në process negocimi dhe në programin e punës është parashikuar të miratohet javën tjetër në datën 27 janar.

18 janar 2022

Debat i hapur mbi Agjendën: Gratë, Paqja dhe Siguria: Shqipëria mori pjesë në Debatin e parë të hapur të KS për këtë vit, dhe u përfaqësua nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaka. Kjo ishte hera e parë që një Ministër nga Shqipëria merr pjesë në një aktivitet të KS në cilësinë e vendit anëtar të Këshillit.

Ministrja Xhaka theksoi rolin thelbësor që luajnë gratë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe aktivitetet e shoqërisë civile në proceset e ndërtimit të paqes dhe sigurisë. Ajo shprehu shqetësimin e vendit tonë për situatën e vështirë dhe sulmet e vazhdueshme ndaj grave aktiviste në zonat e konfliktit. Në këtë kontekst, ajo e cilësoi si të papranueshme çdo formë sulmi apo hakmarrjeje ndaj grave e që vjen si pasojë e angazhimit të tyre social. Prezantimi i Ministres pati jehonë në mediat në vend.

Prezantimi i Ministres Xhaka u vlerësua lart nga misionet e vendeve partnere (Franca, Zvicra, Norvegjia, Belgjika, Irlanda) si dhe nga UN Women. Përfaqësimi ynë në këtë nivel ishte një shprehje e qartë e rëndësisë që Shqipëria i jep temës së WPS dhe vullnetit tonë për të mbështetur përpjekjet për avancimin e kësaj agjende në KS.

Shënim: Cështja e Grave, Paqes dhe Sigurisë është përparësia kryesore e Shqipërisë në KS. Së bashku me disa vende të tjera në Këshill, vendi ynë po punon në mënyrë intensive për ta mbajtur këtë cështje lart në agendën e KS.

25-vjetori i krijimit të mandatit të CAAC: Së bashku me një numër vendesh të tjera të OKB-së, Shqipëria bashkë-sponsorizoi dhe mori pjesë në aktivitetin e nivelit të lartë për krenimin e 25 vjetorit të krijimit të mandatit të Zyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Fëmijët dhe Konfliktet e Armatosur. Shqipëria vlerësoi lart punën e bërë nga Zyra e Përfaqësuesit Special dhe shprehu mbështetje për konsolidimin e arritjeve, duke theksuar se në cilësinë e vendit anëtare të Këshillit të Sigurimit, Shqipëria do të punojë për të integruar më mirë dispozitat për mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha mandatet e Operacioneve Paqeruajtëse të OKB-së.

19 janar 2022

Procesi i paqes në Lindjen e Mesme: Këshilli i Sigurimit zhvilloi debatin e hapur tremujor mbi “Situatën në Lindjen e Mesme, duke përfshirë çështjen palestineze”. Takimi u kryesua nga Ministrja e Jashtme e Norvegjisë, Anniken Huitfeldt. Norvegjia e ngriti kryesimin dhe pjesëmarrjen në këtë takim në nivel ministror për të treguar vëmendjen që i kushton situatës si dhe për të theksuar nevojën e ringjalles së procesit të paqes. Para debatit, Këshilli dëgjoi Tor Wennesland, Koordinatorin i Posaçëm të OKB për Procesin e Paqes në Lindjen e Mesme, dhe dy përfaqësues të shoqërisë civile nga EcoPeace, Nada Majdalani dhe Gidon Bromberg. Përveç vendeve anëtare të Këshillit, në debat morën pjesë edhe 24 vende/organizata të tjera.

Informuesit e vunë theksin në përkeqësimin e situatës së sigurisë në territoret e pushtuara, duke përfshirë sulmet e kolonëve ndaj palestinezëve dhe sulmet palestineze ndaj ushtarëve dhe civilëve izraelitë. Dëbimi i palestinezëve nga lagjja Sheik Jarrah dhe prishja e shtëpive të tyre, zgjerimi i mëtejshëm i vendbanimeve, morën vëmendje të veçantë. Këshilli u paralajmërua gjithashtu se nëse nuk ndalen këto zhvillime negative, të cilat pengojnë mbajtjen gjallë të perspektivës së zgjidhjes së konfliktit mes palestinezëve dhe izraelitëve, kolapsi dhe destabiliteti në rajon do të jetë i pashmangshëm.

Gjatë debatit hapur, shumica e folësve mbështetën kuadrin e OKB-së për zgjidhjen paqësore të konfliktit dhe i bënë thirrje palëve në konflikt për të ndaluar çdo veprim të njëanshëm, përfshi zgjerimin e vazhdueshëm të vendbanimeve në territoret e pushtuara, për të lejuar një zgjidhje me dy shtete. Njëkohësisht thirrje u bë për rifillimin e procesit të paqes, çka kërkon vullnetin dhe kurajon e njëmendtë të dy palëve për bisedime të qenësishme.

Ambasadori Hoxha theksoi rëndësinë e hapave dhe masave praktike për krijimin e besimit mes palëve për të lejuar zgjidhjen me dy shtete, me Jerusalemin si kryeqytet të përbashkët. Duke mbështetur plotësisht të drejtën e Izraelit për t'u mbrojtur, Ambasadori theksoi gjithashtu “nevojën për të respektuar të drejtat e plota dhe të barabarta si të izraelitëve ashtu edhe të palestinezëve, në

mënyrë që të arrihet një zgjidhje e drejtë dhe e qëndrueshme ku të dy popullsitë përkatëse të jetojnë në paqe, siguri dhe dinjitet.”

Shënim: Kjo ishte nga debatet më të vështira të kësaj jave, pavarësisht se ky diskutim bëhet shpesh në KS. Është e rëndësishme që vendi ynë të mbajë një linjë të qartë veprimi për këtë çështje, për të ruajtur koherencën e qendrimit, vijimësinë e linjësimit me Bashkimin Evropian por edhe ndjeshmëri të tjera në një kuadër më të gjerë. Misioni nuk mori pjesë në deklaratën e përbashkët publike (media stakeout) të vendeve anëtare të BE-së në Këshill (Francë dhe Irlandë) për të dënuar zgjerimin e mëtejshëm të vendbanimeve izraelite në territoret e pushtuara, cka nuk është pritur mirë nga vendet në fjalë si dhe nga delegacioni i BE-së në OKB. Po ashtu, Egjipti në OKB shprehu zhgënjim për mospjesëmarrjen e Shqipërisë në këtë ushtrim. Në përputhje me udhëzimet, Misioni ka bërë sqarimet e nevojshme për pozicionin e mbajtur.

20 janar 2022

Kolumbi: Këshilli diskuton cdo gjashtë muaj mbi situatën në Kolumbi dhe në mënyrë të vecantë mbi zbatimin e Marrëveshjes Përfundimtare të Paqes me FARK. Në nëntor të vitit të kaluar, u shënuua pesë vjetori i i Marrëveshjes së Paqes mes qeverisë kolumbiane dhe forcave të FARC.

Këshilltari i Presidentit kolumbian për çështjet e stabilizimit dhe konsolidimit José Archila, Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm për Kolumbinë dhe Drejtues i Misionit të verifikimit Carlos Ruiz Massieu si dhe një përfaqësuese nga shoqëria civile dhe njëkohësisht bashkëshorte e një luftëtari të FARC informuan këshillin para debatit.

Gjatë takimit, vendet anëtare të Këshillit dhanë vlerësime për ecurinë e procesit të paqes, përshendetën arritjet e deritanishme në zbatimin e marrëveshjes. Në të njëjtën linjë, ambasadori Hoxha vlerësoi përpjekjet dhe arritjet e bëra nga qeveria dhe populli kolumbian duke theksuar se ky proces i vështirë dhe kurajoz meriton jo vetëm vlerësimin e Këshillit të Sigurimit, por edhe më gjerë si një shembull inspirues për shumë vende e rajone të tjera në botë.

Shënim: Para takimit vendet e Këshillit që kanë miratuar “Angazhimet e Përbashkëta për Agjendën: Gratë, Paqja dhe Siguria - WPS), Shqipëria, Norvegjia, EBA si dhe Kolumbia, bënë një dalje publike të përbashkët për të theksuar aspektet e zbatimit të marrëveshjes që kanë të bëjnë me Agjendën WPS. Misioni është duke reflektuar për iniciativa të ngjashme nga ana jonë gjatë presidencës së Këshillit në qershor 2022.

Testimet e reja balistike nga Koreja e Veriut: Shqipëria së bashku me SHBA-të, Britaninë e Madhe dhe Francën, kërkuan, vetëm dhjetë ditë pas seancën së parë, zhvillimin e një seance të dytë urgjente të Këshillit për të analizuar situatën pas vazhdimit të testeve balistike nga Koreja e Veriut.

Para takimit, Shqipëria, SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Japonia, Irlanda, Brazili dhe Emiratet e Bashkuara Arabe dënuan, përmes një deklaratë publike (media stakeout) të lexuar nga SHBA-

të, intensifikimin e testeve balistike në dy javët e fundit nga Republika Popullore Demokratike e Koresë. Në deklaratën e përbashkët u nënvizua dhe njëherë se përdorimi i teknologjisë së raketave balistike përbën shkelje të qartë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe se këto fakte nuk duhet të vihen në diskutim. Ato theksuan se aktivitete të tilla të paligjshme janë kërcënim i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe kërkojnë që KS të ruajë unitetin e tij në dënimin e veprimeve të RPKD-së, i cili në të kaluarën që ka ndihmuar të risjellë në tavolinën e bisedimeve RPKD-në dhe që ka mundësuar përparimin për paqen dhe stabilitetin si në rajon ashtu edhe më gjerë.

Ambasadori Hoxha, në tandem me qendrimet e vendeve njëmendës, theksoi se “me qëndrimin e papërgjegjshëm të regjimit në Korenë e Veriut, Këshilli i Sigurimit po sfidohet hapur; nuk po respektohet; vendimet e tij po shpërfillen dhe autoriteti i tij po çënohet. Kjo nuk mund dhe nuk duhet të tolerohet. Prandaj, ne duhet të tregojmë unitet në adresimin e kësaj, pasi kjo vlen për besueshmërinë e punës sonë.”

SHBA-të kërkuar që, për hir të transparencës dhe qartësisë për publikun të përcillej një mesazh publik përmes një deklaratë të shkurtër publike. Miratimi konsensual i elementeve të mësipërm ndeshi kundërshtinë e Kinës (e mbështetur nga Rusia) e cila e konsideroi madje provokim dhe kërkoj që “të mos i hidhej benzinë zjarrit”

Shënim: Sic edhe ndodhi herën e parë, kjo çështje pati mbulim mediatik dhe pati interes për informacion nga media. SHBA-të falendëruan Misionin për qëndrimin e mbajtur në Këshill dhe mbështetjen e pozicionit të SHBA-ve, në një diskutim kompleks e të vështirë gjatë seancës së mbyllur.

21 janar 2022

Me kërkesën e EBA, Këshilli zhvilloi një takim përtej agendës së miratuar, për të diskutuar mbi sulmin e koordinuar të Huthi ndaj Abu Dhabi. Të gjitha vendet e Këshillit dënuan hapur t sulmet dhe shprehën solidaritet me EBA. Disa vende nuk harruan të theksojnë me nuancat e nevojshme, aspekte të tjera të konfliktit në Jemen, përfshirë situatën humanitare dramatike.

Në përputhje me qëndrime të mëparshme, përfshirë nga Ministria Xhacker, Ambasadori Hoxha shprehu mbështetje të plotë për EBA dhe ndër të tjera theksoi se “kur integriteti territorial dhe sovraniteti i një vendi kërcënohen, kur civilët dhe infrastruktura civile sulmohen qëllimisht dhe vihen në rrezik me të vetmin qëllim për të frikësuar dhe terrorizuar popullsinë civile, Këshilli duhet të reagojë me vendosmëri. Ajo që dëgjuam dhe pamë, është tronditëse dhe e tmerrshme. Ne përsërisim dënimin tonë të fortë për këtë sulm të fundit Huthi ndaj Emirateve të Bashkuara Arabe dhe kujtojmë se ai ndjek një model që dihet: sulmet e shumta raketore, përfshirë përdorimin e raketave balistike kundër vendeve fqinjë, qyteteve e civilëve.”

Misioni mori pjesë edhe në një dalje publike të përbashkët të shumicës së vendeve të Këshillit e ku Amb e EBA lexoi deklaratën e miratuar nga Këshilli.

Edhe përkundrejt kundërshtive fillestare, Këshilli ia doli të miratojë një deklaratë për dënimin e sulmeve Huthi, duke përdorur një fjalor të ashpër dhe mbi të gjitha duke i cilësuar ato si sulme terroriste. Rusia, e cila e kundërshtoi tesktin fillimisht dhe kërkoi që të hiqej cdo referencë mbi terrorizmin, përfundimisht u pajtua, pa dhënë shpjegime. Sipas informacioneve të Misionit, Rusia është bindur pas takimeve të zhvilluara në Moskë e ku është ofruar një shpejgim i detajuar e bindës mbi silmet e koordinuara nga Huthi kundër EBA (sic u bë edhe në këshill)

Kryesimi i Komitetit të Sanksioneve: Në përputhje me vendimin për ndarjen e kryesimit të organeve ndihmëse, Ambasadori Hoxha kryesoi takimin e parë të Komitetit të Sanksioneve mbi Jemenin.

Komiteti dëgjoji shpjegimet e detajuara të Panelit të Ekspertëve mbi situatën e konfliktit, respektimin e embargos, situatën ekonomike dhe financiare si dhe problematikën e respektimit të të drejtave të njeriut.

Komiteti diskutoi gjerësisht mbi një numër rekomandimesh. Për shkak të kundërtimit të Rusisë dhe Kinës, edhe përpos mbështetjes nga vendet përendimore, komiteti miratoi vetëm një rekomandim (19 • sugjeron që Komiteti të inkurajojë Shtetet Anëtare të rrisin mbështetjen për aktivitetet e çminimit, duke përfshirë trajnimet për personelin e çminimit, në Jemen), ndërkohë që Kryetari do të vijojë diskutimet informale për të shfrytëzuar cdo mundësi kompromnisi për rekomandimet e tjera.

#